

1. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E PARASË GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2013

Tabelë 1: Vëllimi i operacioneve të përkohshme të tregut të hapur (në milionë lekë*).

DATA	R/REPO njëditore	R/REPO njëjavore	R/REPO njëmujore
04.07.2013		17,560.00	2,000.00
11.07.2013		13,710.00	1,800.00
18.07.2013		20,060.00	1,850.00
25.07.2013		17,450.00	2,000.00
01.08.2013		19,550.00	1,900.00
09.08.2013		15,160.00	1,700.00
15.08.2013		17,200.00	1,700.00
22.08.2013		11,800.00	1,700.00
29.08.2013		16,690.00	2,000.00
05.09.2013		9,200.00	1,800.00
12.09.2013		8,400.00	2,000.00
19.09.2013		9,400.00	2,000.00
23.09.2013	900.00		
26.09.2013		11,300.00	2,000.00

Ndërhyrjet në tregun e parasë, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013, përfshijnë operacione të tregut të hapur për injektim të likuiditetit dhe operacione të përhershme, me qëllim strukturimin e portofolit të BSH-së.

Sasia totale e likuiditetit të injektuar ka rezultuar mesatarisht 17.38 miliardë lekë, kundrejt 18.89 miliardë lekë që ishte në tremujorin e dytë. Likuiditeti mesatar për tremujorin e tretë të vitit 2013 rezulton vetëm 2% më i ulët se 1 vit më parë, kur kjo vlerë ishte 17.8 mld lekë.

Për injektimin e likuiditetit, Banka e Shqipërisë përdori instrumentin e saj kryesor, marrëveshjen e anasjelltë të riblerjes me maturim njëjavor, mesatarisht 14.42 miliardë lekë në javë*, shoqëruar njëkohësisht me marrëveshje të anasjelltë riblerjeje me maturim njëmujor, mesatarisht 1.88 miliardë lekë në javë*. Operacioni injektues njëditor është përdorur vetëm në një rast, me qëllim korrigjimin e sasisë së

likuiditetit në sistem në ditën e fundit të mbajtjes së rezervës së detyruar, në datë 23.09.2013.

Me qëllim strukturimin e portofolit të BSH-së, duke synuar uljen e zotërimit në bono 3 dhe 6-mujore, kompensuar kjo me rritje në emetimet 12-mujore, gjatë tremujorit të tretë të vitit 2013 janë kryer operacionet e shitblerjeve me të drejta të plota, të cilat konsistojnë në një transaksion për shitje të bonos së thesarit 3-mujore të sapoemtuar për shumën 600 milionë lekë*, si dhe katër ndërhyrje në treg të hapur për blerje të bonove të thesarit 12-mujore shoqëruar me tentativa për kryerjen e transaksioneve dypalëshe, nga të cilat u arrit të realizohet blerja e bonove 12-mujore për shumën 560 milionë lekë.

1.2. Përdorimi i instrumenteve mbështetëse


Depozita njëditore është përdorur rregullisht gjatë tremujorit të tretë të vitit në total në 64 raste, mesatarisht 1.98 miliardë lekë, ndërkohë që në tremujorin e kaluar ky instrument ka regjistruar të njëjtën mesatare por në më pak raste përdorimi, përqëndruar në vetëm 28 ditë të tremujorit.

Instrumenti i kredisë njëditore është përdorur në 3 raste, mesatarisht 2.30 miliardë lekë, përqëndruar në ditët e fundit të tre periudhave të mbajtjes së rezervës së detyruar të këtij tremujori. Gjatë tremujorit të dytë të vitit, ky instrument u përdor në 4 raste, mesatarisht 2.02 miliardë lekë.

Grafiku i mëposhtëm paraqet në mënyrë të përmblëdhur ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë për periudhën 2011-2013.

* Shifrat janë të shprehura në vlerë nominale.

Grafik 1: Ndërhyrjet e Bankës së Shqipërisë në tregun e parasë, në periudhën 2011-2013 (me çmim blerjeje).




2. NDËRHYRJET E BANKËS SË SHQIPËRISË NË TREGUN E BRENDSHËM VALUTOR GJATË TREMUJORIT TË TRETË TË VITIT 2013

2.1 Veprime me bankat e nivelit të dytë

Banka e Shqipërisë ka ndërhyrë në tregun e brendshëm valutor gjatë tremujorit të tretë të vitit, duke blerë gjithsej 3.35 milionë euro në dy ditë gjatë muajit gusht. Blerjet janë bërë në funksion të përmbushjes së objektivit të BSh-së për të rritur rezervën valutore.

Në shtator është publikuar edhe lajmërimi për organizimin e një ankandin për blerjen e 2-5 milionë euro në 10 tetor. Shuma e synuar për t’u blerë në këtë ankand është sërish në përmbushje të të njëjtit objektiv.



2.2 Veprime me institucione të tjera

Gjatë tremujorit të tretë kanë vijuar të lidhen kontratat *swap* në valutë dhe lekë midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, nxitur nga nevoja e menaxhimit të likuiditeteve të kësaj të fundit. Blerjet e valutës së BSh-së nga Ministria e Financave gjatë kësaj periudhe qenë 20,910.41 milionë lekë, ndërsa shitjet 20,965.90 milionë lekë. Në nivel *outstanding*, në fund të tremujorit të tretë, vlera e kontratave *swap* të pamaturuara ishte 67.0 milionë euro, nga 62.8 milionë euro që rezultoi një tremujor më parë.

Blerjet e valutës nga institucionet e huaja llogariten në 207.09 milionë lekë (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim – IBRD dhe Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim – IDA).

Institucioni financiar	Blerje të valutës (në milionë lekë)	Shitje të valutës (në milionë lekë)
MINISTRIA E FINANCAVE (SWAP)	20,910.41	20,965.90
TË TJERA (IDA, IBRD)	207.09	